



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	19-04	2022	2	viti god year
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK/C	2229/2022		116	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.259/2022

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë, me Sabile Avdyl-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2573/2021 të datës 15.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.817/2021 të datës 17.09.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.817/2022 e datës 17.09.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. **Anulohet** Vendimi Nr.111/01-28329/2021 i datës 14.09.2021 i Menaxheres së Personelit të Komunës së Kaçanikut si dhe procedura e rekrutimit me numër reference RN00007346 të datës 27.07.2021 për pozitën Specialist i Buxhetit, në Sektorin për Buxhet dhe Zhvillim Ekonomik.
- III. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Kaçanikut që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja kandidatë për pranim në shërbimin civil, më datë 17.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.111-

01-28329/2021 të datës 14.09.2021 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Kaçanikut, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 20.09.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kaçanikut, ndërsa kjo e fundit më datë 04.10.2021 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë si dhe provat lidhur çështjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, përmes shkresës me numër protokoll 5052/2021 të datë 15.10.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me pamundësinë e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës së tij të datës 17.09.2021, dhe njeherit ka udhëzuar të njëjtën për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 15.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2573/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses ka anuluar Njoftimin e Këshillit të datës 15.10.2021 dhe ka detyruar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditëses të datës 17.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:
Ankesën e datës 17.09.2021 me numër protokoll 4679/2021 të datës 17.09.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 14.09.2021 Nr.111/01-28329/2021 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 03.09.2021 nga menaxherja e Personelit; Diplomën e datës 06.03.2021 me nr.4989 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin Hasan Prishtina në Prishtinë për Vërtetimin e datës 01.09.2021; Referencë e datës 31.12.2017; Vërtetimin e Punës të datës 01.09.2021; E-mail zyrtar i datës 01.10.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2021 me numër protokoll 04.10.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/122; Kërkesën për fillimin e rekrutimit të datës 18.03.2021; Kopja e konkursit prej datës 08.04.2021 deri më datë 16.04.2021; Njoftimin e datës 27.04.2021; Kopjen e konkursit e datës 17.08.2021; Listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për aplikim e datës 06.09.2021; Ankesën e datës 13.09.2021 e parashtruar nga ankuesja përmes avokatit tek menaxheri i personelit në Komunën e Kaçanikut; Vërtetimin e punës së datës 01.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; Flete dorëzim i datës 14.09.2021; E-mail zyrtar i datës 22.09.2021 njoftim për mbajtjen e testit me shkrim për datën 24.09.2021; E-mail zyrtar i datës 28.09.2021 për njoftimin e mbajtjes së testit me gojë; Vendimi i datës 15.09.2021 me Nr.01/111/01-8410/21 për formimin e Komisionit të pranimit në Shërbimin civil; Njoftimi për kandidatin fitues i datës 30.09.2021; E-mail zyrtar i datës 03.09.2021; Raporti dhe lista e vlerësimit përfundimtar të komisionit të pranimit i datës 30.09.2021; E-mail zyrtar i datës 30.09.2021; Vërtetimin e punës së datës 05.10.2021; Certifikatën e datës 04.04.2016; Diplomën e datës 07.12.2016 e lëshuar nga Kolegji AAB për Vërtetimin e kopjes me origjinalin te noteri; Udhëzimi Administrativ me nr.19/2014; Referencë për punësim ; Referencën e datës 31.12.2017; Aplikacioni për i datës 24.08.2021; Aplikacionin e datës 24.08.2021 për Certifikatën e datës 17.03.2014; Kontratë e punës për kohë të caktuar/të pacaktuar prej datës 01.06.2019 deri më datën 31.07.2021; Pasqyrën e llogarisë së trustit prej datës 18.08.2010 deri më datën 18.08.2021; Vërtetimin mbi përvojën e punës i datës 19.08.2021 prej datës 01.03.2018 deri më datën 30.04.2018; Certifikatën e datës 27-28.09.2018; Certifikatën e datës 16.02.2016-11.05.2016; Certifikatën e datës 13.09.2018;

Diplomën e shkollës së mesme të datës 07.06.2010; Referencën për punësim për [redacted] prej datës 01.06.2019 deri më datën 31.07.2021; Vërtetimin e datës 20.02.2020; Diplomën e datës 13.12.2019 me Nr.27744/19 e lëshuar nga Kolegji AAB për [redacted] Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës e datës 23.08.2021; Pasqyra e llogaris së trustit pensional prej datës 01.01.2015 deri me datë 18.08.2021; Vërtetimin për punë i datës 30.06.2018 për [redacted] Aplikacionin e datës 23.08.2021 për [redacted] Certifikatën e datës 20.02.2017; Diplomën e datës 07.09.2016 me Nr.898/2016 të lëshuar nga Kolegji AAB për [redacted] Certifikatën e datës 13.08.2021e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Vërtetimin e datës 20.09.2019; Vërtetimin e datës 13.07.2020; Kopja e letërnjoftimit për [redacted] Vërtetimin e datës 01.09.2016; Shkresën për përvojë të punës për [redacted] Vërtetimin e datës 19.08.2021; Diplomën e datës 15.10.2014 me Nr.209/14 për [redacted] i lëshuar nga Kolegji Iliria; Vendimin e datës 30.04.2018; Vërtetimin e datës 13.08.2021; Certifikatën e datës 11.11.2015; Aplikacionin e datës 23.08.2021 për [redacted] Diplomën e datës 05.12.2020 me Nr.11304 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Vërtetimin e datës 19.08.2021; certifikatën e datës 18.08.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj; Vërtetimin e datës 17.09.2021; Aplikacionin për [redacted] i datës 24.08.2021; Diplomën e datës 28.05.2019 me Nr.644/19 i lëshuar nga Kolegji AAB; Aplikacionin e datës 23.08.2021 për [redacted] Vendimin e datës 31.12.2021; Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës i datës 12.08.2021; Pasqyrën e llogarisë së trustit prej datës 01.01.2019 deri më datën 10.08.2021; Vërtetimin e datës 05.10.2016; Akt emërimi e datës 17.01.2014; Aktgjykimin A.nr.2573/2021 ë datës 15.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; E-mailin zyrtar i datës 19.11.2021 dhe Njoftimin me numër protokolli 5052/2021. të datës 15.10.2021

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankueses [redacted] **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Komuna e Kaçanikut, më datë 24.03.2021 ka shpallur Konkurs me numër reference RN00006577 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës *Specialist i Buxhetit, klasa profesional 2*. Komuna e Kaçanikut përmes njoftimit të datës 27.04.2021 ka përfunduar konkursin në fjalë në fazën e verifikimit paraprak, për shkak së në këtë konkurs nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Organi i punësimit më datë 27.07.2021 ka shpallur njoftimin për konkurs të jashtëm me numër reference RN00007346, për pozitën e njëjtë të punës *Specialist i Buxhetit*, i hapur për aplikim nga data 17.07.2021 deri me 24.08.2021, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji gjen së në Konkursin me numër reference RN00007346 kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6) kandidatë, ku në listën e ngushtë të datës 06.09.2021 janë përzgjedhur vetëm tre (3) kandidatë dhe atë [redacted] dhe [redacted] ndërsa ankuesja me datë 03.09.2021 është informuar përmes adresës elektronike private të saj së e njëjta nuk është përfshirë në listën e ngushtë sepse nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës të kërkuar me konkurs.

E pakënaqur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, ankuesja me datë 13.09.2021 ka parashtruar ankesë pranë Komunës së Kaçanikut. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut me Vendimin Nr.111/01-28329/2021 të datës 14.09.2021 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses. Ankuesja kundër këtij vendimi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedues administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00007346 për pozitën e punës Specialist i Buxhetit, ka përcaktuar kushtet e përgjithshme formale, si në vijim: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në Fakultetin Ekonomik, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës konstaton se pretendimet ankimore të ankueses i referohen fazës së verifikimit paraprak, por që sipas provave materiale të përcjella nga organi i punësimit rezulton së procedura e rekrutimit për pozitën e punës Specialist i Buxhetit ka përfunduar me shpalljen e kandidatit fitues respektivisht sipas Njoftimit 01 Nr.111/01-8410/2021 të datës 30.09.2021 kandidatja është përzgjedhur si kandidate fituese.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregullore, për pozitën e punës Specialist i Buxhetit e renditur me kodin 3, fusha e arsimit të kërkuar është *Ekonomik, specialiteti financa apo kontabilitet*, ndërsa me Konkursin me numër reference RN00007346, si fushë e arsimit është përcaktuar vetëm Fakulteti ekonomik, e që sipas vlerësimit të Kolegjit organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Po nga shqyrtimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së proceduara e rekrutimit me numër reference RN00007346 është përfshirë edhe me shkelje të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 me të cili është përcaktohet se: *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve....* rrjedhimisht Kolegji në vështrim të këtyre dispozitave ligjore dhe bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut, në fazën e verifikimit paraprak nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kandidatët të cilët nuk kanë plotësuar kushtet për pozitën e shpallur, mirëpo të njëjtit janë njoftuar vetëm përmes emailit. Ndërlidhur me këtë konstatim, Kolegji vlerëson së qëllimi i normës në fjalë konsiston në detyrimin e organit të punësimit që të nxjerrë akt administrativ për çdo kandidat që nuk ka plotësuar kushtet sipas konkursit, dhe se vendimi në fjalë duhet të përmbaj të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ ashtu që pala të jetë në dijeni lidhur situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, përkatësisht akti administrativ duhet ti përmbaj të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatës [redacted] e përzgjedhur fillimisht në listën e ngushtë e pastaj edhe si kandidate fituese, është konstatuar se e njëjta sipas Diplomës me Nr.11304 të datës 28.09.2020 ka përfunduar Fakultetin Ekonomik më datë 28.09.2020 në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me gjithsej 180 pikë-ECTS, dhe rrjedhimisht Kolegji konstaton se bazuar në kërkesat e përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil kandidatja fituese nuk ka plotësuar kriterin e fushës së arsimit për pozitën e shpallur. Ndërsa lidhur me kriterin e përvojës së punës e njëjta me rastin e aplikimit ka ofruar: Vërtetimin e Komunës së Kaçanikut 01 Nr.113/01-24372/2021 të datës 19.08.2021 me të cilin është vërtetuar së e njëjta ka qenë e punësuar në pozitën Asistente Administrative e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, për periudhën kohore nga data 01.03.2018 deri 03.09.2018, ndërsa nga data 04.09.2018 e tutje ka vazhduar të punoj në pozitën Zyrtare Administrative në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut; Kontratën e Punës të datës 01.06.2019, me të cilin është vërtetuar se ka punuar si Zyrtare Financiare me orar të plotë në Kompaninë "KAT Consulting" SHPK nga data 01.06.2019 deri 31.07.2021; si dhe Vërtetimin Nr.024/2020 të datës 20.02.2020 më të cilin është vërtetuar së kandidatja e përzgjedhur ka punua si arkëtare në Kompaninë "Mobi Computers" SHPK për periudhën nga data 17.07.2017 deri me 31.08.2019.

Kolegji nga shqyrtimi i provave lidhur me përvojën e punës së kandidatës së përzgjedhur vlerëson se dëshmitë e ofruara janë kundërthënëse njëra me tjetrën, sepse, Kontrata e punës e datës 01.06.2019 tek Kompania "KAT Consulting" SHPK nuk është e nënshkruar nga kandidatja e përzgjedhur në cilësi të punësuarës, periudha e punës e deklaruar nga vet kandidatja nuk është në përputhje me Pasqyrën e Trusit-it Pensional sipas të cilës rrjedhë se e njëjta është deklaruar nga punëdhënësi vetëm për 23 muaj e jo 26 muaj siç pretendon kandidatja, po ashtu deklarimi i kontributeve pensionale nuk është bërë në periudha mujore, por për të gjitha periudhat dhe atë pasi që organi i punësimit ka publikuar njoftimin për hapje të Konkursit me numër reference RN00007346, gjegjësisht ky njoftim është bërë me datë 27.07.2021 ndërsa deklarimi i kontributeve pensionale është bërë më datë 16.08.2021 dhe 17.08.2021(pra në ditën e hapjes së konkursit për aplikim). Nisur nga këto fakte, rrjedhë se organi i punësimit ka qenë i obliguar që të konstatoj vërtetësinë e këtyre dokumenteve ashtu siç përcaktohet me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar si me lartë, Kolegji vlerëson së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar as kriterin e përvojës së punës, ngase përvoja e punës në Komunën e Kaçanikut dhe përvoja e punës në kompaninë "Mobi Computers" SHPK, nuk konsiderohet përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, ndërsa lidhur me përvojën e punës në Kompaninë "KAT Consulting" SHPK, sipas Pasqyrës së Trustit Pensional e njëjta ka vetëm 23 muaj përvojë pune pra 1 vit e 11 muaj, kështu që mbi këto arsye rrjedhë se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut, ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim.*

Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë, ndërsa Komisioni i Pranimit nuk ka respektuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është theksuar se: *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve.* 2. *Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.*

Bazuar në rrethanat si me lart, Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kaçanikut me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.111/01-28329/2021 të datës 14.09.2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankueses nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike si dhe nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.259/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësit të Personelit Komunën e Kaçanikut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

